

UDHËZIM

Nr. 622, datë 11.11.2016

PËR MIRATIMIN E MODELIT TË ADRESËS DHE RADHËN E VENDOSJES SË ELEMENTEVE TË SAJ

Në zbatim të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 3, të ligjit nr. 89/2016, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9270, datë 29.7.2004, “Për sistemin e adresave”, të ndryshuar, me qëllim zbatimin e një procesi unik të pasqyrimin të adresës, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile,

UDHËZOJ:

1. Elementet e adresës do të shkruhen sipas kësaj radhe:

- emri i bulevardit/ rrugës/ rrugicës/ sheshit ose parkut;
- numri i ndërtesës “Nd”, numri i hyrjes “H”, numri i apartamentit “Ap”;
- emri i qytetit/fshatit, emri i njësisë administrative, kodi postar;
- emri i bashkisë.

Në çdo rast emri i rrugës, si dhe emrat e bashkisë dhe njësisë administrative, shkruhen me germa të mëdha. Nëse ka shkurtime pas tyre vendoset “.”.

2. Elementet për ndërtesën, hyrjen dhe apartamentin do të shkruhen në një rresht dhe do të ndahen ndërmjet tyre me shenjën “,” ose “;”.

Në rastet kur mungon numri i hyrjes së ndërtesës dhe numri i apartamentit do të thotë se ndërtesa ka përkatësisht një hyrje dhe hyrja ka vetëm një apartament. Në këtë rast do të shkruhet vetëm numri i ndërtesës.

Në rastet kur mungon numri i apartamentit do të thotë se ndërtesa ka përkatësisht një hyrje dhe hyrja ka vetëm një apartament. Në këtë rast do të shkruhet numri i ndërtesës dhe numri i hyrjes.

3. Emrat që përcaktojnë elementet fshat/ qytet/njësi administrative dhe kodi postar , do të shkruhen në një rresht, të ndarë midis tyre me shenjën “,” dhe “;”.

4. Emri i Bashkisë do të shkruhet në rreshtin e fundit në rastet kur kemi adresë brenda vendit dhe kur kemi adresë për jashtë vendit do të shtohet dhe emri i shtetit në të njëjtin rresht me emrin e bashkisë të ndarë midis tyre me shenjën “,” dhe “;”.

5. Modeli i shkrimit do të jetë sipas rasteve të mëposhtme:

a) Në rastet kur kemi për të shkruar adresën në Bashkinë Tiranë:

Rr. "MYSLYM SHYRI"

Nd.5, H.2, Ap.12

Njësia Administrative Nr.10, 1001

TIRANË

Rr. "MYSLYM SHYRI"

Nd.5; H.2; Ap.12

Njësia Administrative Nr.10; 1001

TIRANË

b) Në rastet kur kemi për të shkruar adresën ku qyteti dhe njësia administrative është me emër të njëjtë me bashkinë:

Rr. "JANI VRUHO"

Nd.5, H.2, Ap.12

5003

BERAT

Rr. "JANI VRUHO"

Nd.5; H.2; Ap.12

5003

BERAT

c) Në rastet kur kemi për të shkruar adresën ku qyteti dhe njësia administrative është me emër të njëjtë, por me emër të ndryshëm me bashkinë:

Rr. "AGIM RAMADANI"

Nd.10, H.2, Ap.12

BAJRAM CURRI, 8702

TROPOJË

Rr. "AGIM RAMADANI"

Nd.10; H.2; Ap.12

BAJRAM CURRI; 8702

TROPOJË

d) Në rastet kur njësia administrative ka emër të ndryshëm nga bashkia:

Rr. "DELIALLISI"

Nd.46, H.1, Ap.3

SUKTH, 2010

DURRËS

Rr. "DELIALLISI"

Nd.46; H.1; Ap.3

SUKTH; 2010

DURRËS

Rr. "KOSOVA"

Nd.23, H.1, Ap.3

LACË, 4701

KURBIN

Rr. "KOSOVA"

Nd.23; H.1; Ap.3

LACË; 4701

KURBIN

e) Në rastet e një fshati me emër të ndryshëm nga emri i bashkisë dhe i njësisë administrative:

Rr. "AVNI BAJRAMI"

Nd.24, H.1, Ap.3

Sheqeras, VRESHTAS, 7028

MALIQ

Rr. "AVNI BAJRAMI"

Nd.24; H.1; Ap.3

Sheqeras; VRESHTAS; 7028

MALIQ

f) Në rastet e fshatrave me emër të njëjtë me emrin e njësisë administrative:

Rr. "LISIT"

Nd.12, H.1, Ap.5

VRESHTAS, 7028

MALIQ

Rr. "LISIT"

Nd. 12, H.1, Ap.5

VRESHTAS; 7028

MALIQ

g) Kur ndërtesat janë të përbëra nga lagje, numërtimi i ndërtesave do të bëhet sipas lagjeve, të cilat më parë duhet të marrin një emër. Emri i lagjes do të zëvendësojë emrin e rrugës edhe në adresë.

Lagja GROPAS

Nd.1, H.2, Ap.4

Mucaj, REMAS, 9004

DIVJAKË

Lagja GROPAS

Nd.1; H.2; Ap.4

Mucaj; REMAS; 9004

DIVJAKË.

h) Kur në fshat nuk mund të emërtojmë rrugët dhe ndërtesat klasifikohen si një grup i vetëm i përbashkët, atëherë nuk shkruhet emri i rrugës.

Nd.2, H.1, Ap.4

Drithas, SHUSHICË, 9406

VLORË

Nd.2; H.1; Ap.4

Drithas; SHUSHICË; 9406

VLORË

6. Të gjitha institucionet publike/private, personat juridikë e fizikë zbatojnë modelin e adresës në çdo format zyrtar që kërkohet. Kryetarët e bashkive u dërgojnë të gjitha institucioneve publike/private, të gjithë personave juridikë dhe fizikë adresën përkatëse, si dhe lajmërimin sa herë që ajo ndryshohet;

7. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;

8. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME

Saimir Tahiri